



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ASAMBLEA E PËRGJITHSHME
UJESJELLES KANALIZIME SH.A PATOS

Nr. 217 Prot

Patos më, 13/04/2023

VENDIM

NR. 04 DATË 13 04 /2023

Sot, më datë 13 Prill 2023, Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime sh.a Patos, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J63208406B mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thir nga administratori i shoqërisë z.Klaudio Alisinanaj, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

Cështjet e rendit të ditës:

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj ne likujdim
- Emërimi i Likuidatorit

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria Ujësjetllës kanalizime sh.a Patos, nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me V.K.M Nr.302, datë 11.05.2022 si dhe marrëveshjen noteriale Nr.1362Rep. dhe Nr.620 Kol, datë 07.10.2022, midis shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a Patos dhe shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 01.01.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar. Për sa konstatohet më sipër. Shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të cregjistrohet nga regjistri tregëtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja vendosi:

1. Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj;
2. Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
3. Emërimin e Znj. Anisa Petani, si likudator të shoqërisë.
4. Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë cdo document të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Pasi u siguroa se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon:

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

KRYETARE
Rajmonda BALILAN

